STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 31 dhjetor 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ZGJIDHJEN E CESHTJES TE CON EDISON

Marrëveshja do të ngrijë tarifat për 2-3 vjet, ndërsa forcohet qëndrueshmëria dhe përmirësohet efektshmëria

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot një marrëveshje të përbashkët me Ndërmarrjen e Konsoliduar Edison të Nju Jorkut, Inc. (Consolidated Edison Company of New York, Inc.) që përfshin një ngrirje të tarifës të dhënies së elektricitetit për dy vjet dhe një ngrirje të tarifës të shpërndarjes së gazit dhe avullit për tre vjet duke filluar më 1 janar 2014. Marrëveshja kërkon gjithashtu që ndërmarrja e shërbimeve të bëjë investime të konsiderueshme për të forcuar qëndrueshmërinë e rrjetit të energjisë, për të përmirësuar efektshmërinë e energjisë dhe për të përshpejtuar kalimin në një sistem më të pastër, më të shpërndarë të energjisë. Kjo marrëveshje rrjedh nga thirrja e Guvernatorit tetorin e kaluar që Komisioni i Shërbimit Publik (Public Service Commission) (PSC) të refuzojë ngritjen e propozuar të tarifave nga ndërmarrja e shërbimeve.

"Kjo është një fitore e pastër për konsumatorët dhe bizneset, veçanërisht ato që vuajtën përmes mungesave të energjisë nga super stuhia Sendi (Sandy) vitin e kaluar," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) meritojnë nivele të qëndrueshme të energjisë dhe një sistem elektrik të besueshëm që është i pastër dhe i fortifikuar për të duruar dhe për të reaguar ndaj pasojave të motit të ardhshëm ekstrem. Me këtë marrëveshje historike, kemi arritur të dy këta elementë kritikë për paguesit e tarifave në Qytetin e Nju Jorkut (New York City) dhe Qarkun Uestçestër (Westchester County). Përgëzoj të gjitha palët, përfshirë personelin e PSC-së, grupet e konsumatorëve dhe të mjedisit dhe Con Edison për përpjekjet e tyre."

Propozimi i marrëveshjes, që pret miratimin nga PSC, u siguron konsumatorëve të Con Edison një ngrirje në tarifat e dhënies bazë për dy vjet për shërbimin elektrik dhe tre vjet për shërbimet e dhënies së gazit dhe avullit. Përveç kësaj, marrëveshja siguron investime të konsiderueshme në qëndrueshmëri dhe forcimin e sistemit; rritje të masave të sigurisë së gazit dhe rritje të zëvendësimeve në tubacione që mund të rrjedhin; zgjerim të programit me të ardhura të ulta; dhe rritje të investimeve në dhe përqëndrim në konvertimet nga nafta në gaz, që do të pakësojë nxjerrjet e ndotjes së ajrit dhe krijimin e shpërndarjes.

Sipas kushteve të propozimit të përbashkët – të nënshkruar nga shumica e palëve, përfshirë personelin e Departamentit të Shërbimit Publik (Department of Public Service), Qyteti i Nju Jorkut (City of New York), dhe disa grupe mjedisore dhe të konsumatorëve – konsumatorët banorë do të marrin një ngrirje të tarifës së dhënies së elektricitetit për dy vjet dhe një ngrirje të tarifës së dhënies së gazit për tre vjet duke filluar më 1 janar 2014. Shumica e kategorive të konsumatorëve tregtarë dhe industrialë do të shohin një ulje të tarifave.

Përveç ngrirjes së tarifës në përfitim të konsumatorëve, përfitime të tjera për konsumatorët e Con Edison përfshijnë:

- Përmirësimin dhe rritjen e zbritjeve që kanë lidhje me programet e të ardhurave të ulta për elektricitetin dhe gazin;
- Sigurimin e rilidhjeve më të shpejta të shërbimit elektrik për banesat duke siguruar burime të ndërmarrjes për të zgjeruar aftësinë e saj për të rilidhur shumicën e konsumatorëve në të njëjtën ditë që ata kanë të drejtë për rilidhjen e shërbimit;
- Forcimin e synimeve për matjen e rendimentit për shërbimin ndaj konsumatorit; dhe
- Zgjerimin e synimeve për matjen e rendimentit për shkeljet e sigurisë së gazit.

Duke pranuar se ndryshimi i klimës është duke ndikuar gjithnjë e më shumë sistemet e shpërndarjes së energjisë të ndërmarrjes në Qytetin e Nju Jorkut (New York City) dhe Qarkun Uestçestër (Westchester County), propozimi i përbashkët rekomandon shpenzimin e $1 milionë për të forcuar dhë për të bërë më të qëndrueshëm sistemet elektrike, të gazit dhe të avullit të ndërmarrjes. Marrëveshja gjithashtu krijon një proces për të financuar propozime të tjera të përbashkëta të miratuara për forcimin dhe qëndrueshmërinë ndaj stuhisë të krijuara gjatë afatit të planeve të tarifave.

Marrëveshja rrit në mënyrë të konsiderueshme sasinë e tubacionit që mund të rrjedhë për t'u zëvendësuar dhe zgjeron programin për të përfshirë zëvendësimin e tubacioneve që mund të rrjedhin në zonat e përmbytjes. Ajo gjithashtu përfshin një studim mbi mënyrat për të pakësuar sasinë e metanit që mund të rrjedhë nga sistemi i shpërndarjes së gazit, e cila nga ana e saj do të kufizojë sasinë e gazeve serë që hyjnë në atmosferë.

Marrëveshja gjithashtu çon përpara teknologjitë e karburanteve më të pastra dhe të reja për të përmirësuar efektshmërinë dhe qëndrueshmërinë. Con Edison do të studjojë mundësinë dhe efektshmërinë e kostos së zgjerimit të sistemeve të mikro-rrjeteve, që janë versione të një shkalle të vogël të sistemit të centralizuar të elektricitetit të krijuar për të arritur synime vendore të caktuara, si qëndrueshmëri, pakësim të lëshimit të karbonit, shumëllojshmërinë e burimeve të energjisë dhe pakësimin e kostos. Marrëveshja kërkon gjithashtu që Con Edison të përmirësojë dhe të zgjerojë programin e saj të konvertimit nga nafta në gaz.

Në janar 2013, Con Edison i kërkoi Komisionit të Shërbimit Publik (Public Service Commission) (PSC) miratimin për një rritje prej 8 përqind të tarifave të dhënies së elektricitetit, 2.5 përqind të gazit dhe 2.3

përqind të tarifave të dhënies së avullit për një vit duke filluar në janar 2014, mes të tjerave. Pas periudhës prej një viti, Con Edison mund të ishte rikthyer tek PSC për miratimin e një rritje tjetër të tarifave.

Në përgjigje të rritjes së propozuar të tarifave nga ndërmarrja e shërbimeve, Guvernatori Kuomo (Cuomo) i dërgoi një letër PSC-së më 8 tetor 2013, duke i bërë thirrje asaj të refuzojë kërkesën e ndërmarrjes së shërbimeve për rritjen e tarifave. Veçanërisht, Guvernatori i kërkoi PSC-së që të stabilizojë tarifat dhe të sigurojë se investimet e ndërmarrjes së shërbimeve me të vërtetë do të jenë në përfitim të konsumatorëve. Propozimi i ri i përbashkët i përmbush të dyja këto synime.

Duke iu bashkuar Departamentit të Shërbimit Publik (Department of Public Service) dhe Con Edison në nënshkrimin e marrëveshjes janë: Qyteti i Nju Jorkut (City of New York), Autoriteti i Energjisë së Nju Jorkut (New York Power Authority), Njësia e Ndërhyrjes për Ndërmarrjet e Shërbimeve e Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit e Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Consumer Protection Utility Intervention Unit), Këshilltarët e Konsumatorëve të Energjisë (Consumer Power Advocates), Këshilli i Konsumatorëve të Energjisë i Nju Jorkut (New York Energy Consumers Council), Fondi i Mbrojtjes Mjedisore (Environmental Defense Fund), Qendra për Ligjin mbi Ndryshimin e Klimës e Kolumbias (Columbia Center for Climate Change Law), Qendra e Klimës PACE (PACE Climate Center), NRG Energy, Inc., dhe Ndërmarrja e Krijimit të Energjisë në SHBA (US Power Generating Company). Propozimi i përbashkët do të nxirret nga PSC për komente publike dhe do t'i nënshtrohet një seance të provave, që do të pasohet nga një vendim i pritshëm i PSC-së në seancën e saj të 20 shkurtit 2014.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418